

Syllabus i lëndës BAZAT E PROJEKTIMIT 1

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Arkitekturës |
| Titulli i lëndës: | BAZAT E PROJEKTIMIT 1 |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | 1/ SEM 1 |
| Numri i orëve në javë: | 4 (2+2) |
| Vlera në kredi – ECTS: | 6 |
| Koha / lokacioni: | Sipas orarit të shpallur |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof.Ass.Dr. Rozafa Basha, i.d.a. |
| Detajet kontaktuese: | rozafa.basha@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | <p>BAZAT E PROJEKTIMIT 1 (GRAMATIKA E PROJEKTIMIT)</p> <p><i>Arkitektura në përgjithësi konceptohet – projektohet – ndërtohet si përgjigje ndaj një sërë konditash ekzistuese. Këto kondita mund të jenë thjesht të natyrës funksionale, si dhe mund të reflektojnë klimën shoqërore, politike dhe ekonomike. Në thelb, manifestimet funksionale të arkitekturës e akomodojnë aktivitetin njerëzor. Aranzhimi dhe renditja e formave dhe hapësirës mund të përcaktojnë mënyrën se si arkitektura i promovon përpjekjet, nxjerr përfundime dhe komunikon kuptime.</i></p> <p><i>Ky kurs mëton t’ia bëjë të njohur studentit të vitit të parë të arkitekturës përkufizimet themelore të formës dhe hapësirës dhe parimet të cilat do t’i ndihmojnë për të vënë rend në mjedisin e ndërtuar. Forma dhe hapësira janë mjete kritike të arkitekturës dhe janë pjesë e fjalorit të projektimit.</i></p> <p><i>Në këtë kurs forma dhe hapësira nuk prezantohen si caqe por si mjete për të zgjidhur problemet që kanë të bëjnë me konditat e funksionit, qëllimit, dhe kontekstit.</i></p> |
| Qëllimet e lëndës: | <p><i>Kursi ka për qëllim t’ua paraqes studentëve një përkufizim të thjeshtësuar të arkitekturës, duke madhështuar aspektin pamor të balansit arkitektonik; si dhe t’i njoftojë studentët me parimet pamore të dizajnit/ projektimit arkitektonik.</i></p> <p><i>Po ashtu, kursi ka për qëllim t’i njoftojë studentët me fenomenet kryesore që përcaktojnë mënyrën e organizimit të hapësirës përmes shqyrtimit analitik të komponentëve elementarë të arkitekturës.</i></p> |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <ul style="list-style-type: none"> <i>Të kuptojë ligjshmëritë dhe karakteristikat pamore të formave, hapësirës, objekteve dhe kompozicioneve të objekteve në veçanti dhe të mjedisit të ndërtuar rrethues në përgjithësi.</i> <i>Të kuptojë përdorimin harmonik të ngjyrave në arkitekturë përmes teorive të harmonisë së ngjyrave</i> <i>Të kuptojë rolin e sistemeve të proporcioneve dhe të masës si mjete të shprehurit arkitektonik</i> <i>Të kuptojë shumësinë e problematikës së krijimtarisë arkitekturale</i> <i>Të jetë i aftë që të shqyrtojë dhe analizojë komponentët arkitektural në vepra arkitekturale të tjera si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake</i> |

| Kontributi në ngarkesën e studentit | | | |
|---|--|------------------|---------------------|
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/ laboratorike | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet | 0.2 | 10 | 2 |
| Ushtrime në terren | | | |
| Kolokuiume, seminare | 1 | 2 | 2 |
| Detyra të shtëpisë | 3 | 13 | 39 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 5 | 10 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 2 | 2 | 4 |
| Projektet, prezantimet | 2 | 4 | 8 |
| Totali | | | 155 ~ 6 ECTS |
| Metodologjia e mësimdhënies: | <p><i>LIGJËRATA – USHTRIME</i></p> <p><i>Ligjërimiti i lëndës bëhet me kombinimin e dy metodave të komunikimit të temave të kursit, me anë të ligjërimit të temave në formën ex-catedra (me ndihmën e mjeteve digjitale), si dhe diskutimit të çështjeve që ndërlidhen me temat e ligjëruara në mënyrë interaktive me studentët.</i></p> <p><i>Ushtrimet janë pjesa thelbësore formësuese në këtë lëndë dhe ato zhvillohen përmes detyrave tematike grafike që punohen dhe diskutohen në klasë, si dhe detyrave grafike shtëpiake. Përmes detyrave grafike studentit i kërkohet t'i zbatojë në mënyrë kreative dhe origjinale temat e diskutuara në ligjërata, në përputhshmëri me udhëzimet që përpilohen nga mësimdhënësja e lëndës. Detyrat grafike do të jenë dy llojesh, individuale dhe grupore. Detyrat grafike shoqërohen edhe me modele/maketa të formës dhe përpjesës që përcaktohet nga mësimdhënësi.</i></p> | | |
| Metodat e vlerësimit: | <p><i>Vlerësimi i punimeve grafike semestrave*:</i> 55 %</p> <p><i>Vlerësimi i pjesës teorike (kollokuiumet/ provimi final):</i> 40 %</p> <p><i>Ndjekja e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve si dhe kryerja dhe dorëzimi me kohë i punimeve grafike përbën:</i> 5 %</p> <p><i>Totali:</i> 100 %</p> <p><i>Vërejtje: Pavarësisht skemës së vlerësimit të mësipërm, studentët që në provim vlerësohen me minimumin kalues (5.5), notë përfundimtare të lëndës do ta kenë notën 6.</i></p> | | |

| | |
|---------------------------|--|
| | <p>Punimet semestrare vlerësohen si në vijim:</p> <p>Punimet grafike individuale** përbëjnë 80 % të totalit të notës së punimeve grafike semestrare</p> <p>Punimet grafike grupore përbëjnë 20% të totalit të notës së punimeve grafike semestrare</p> <p>Punimet grafike individuale** ndahen në:</p> <p>Punimet individuale grafike shtëpiake – 60 % të notës së Punimeve Individuale Grafike</p> <p>Punimet individuale grafike klasore – 40 % të notës së Punimeve Individuale</p> |
| Literatura | |
| Literatura bazë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Ligjëratat e përgatitura nga mësimdhënësja (Materiali i përditësuar i ligjëratave, pas çdo njësie të shpjeguar, distribuohet përmes e-mailit nga mësimdhënësja në formatin .pdf.)</i> 2. <i>Skripta e përgatitur nga Prof. Ass Dr. Rozafa Basha.</i> 3. <i>'Architecture, Form, Space and Order" Francis D.K.Ching – John Wiley&Sons, 2015.</i> 4. <i>'Experiencing Architecture" Steen Eiler Rasmussen - MIT Press.</i> 5. <i>'Excercises in Architecture – Learning to Think as an Architect', Simon Unwin, Routledge,2012</i> 6. <i>Analyzing Architecture, 4th Edition, Simon Unwin, Routledge, 2014</i> 7. <i>Nina Ugljen Ademovic, Arhitektura i osnove arhitektonskog projektiranja, Arhitektonski fakultet, Univerziteta u Sarajevu, 2018</i> 8. <i>"Elements of Color", Johannes Itten</i> 9. <i>'Understanding Architecture', Robert McCarter, Juhani Pallasma, Phaidon Press, 2012</i> 10. <i>'Libri decem de la Architectura' Marcus Polio Vitruvius.</i> 11. <i>'Drejt një Arkitekture' Le Corbusier - Phoenix 2000.</i> 12. <i>'Le Corbusier - L'architettura come armonia' Jean Jengers – Universale Electa/Gallimard 1993.</i> 13. <i>'Questions of perception – phenomenology of architecture', - Steven Holl, Juhani Pallasamaa, Alberto Perez-Gomez – William Stout publishers San Francisco 2006</i> 14. <i>'The Eyes of the Skin: Architecture and the Senses', Juhani Pallasma - John Wiley & Sons; 2nd edition, 2005</i> 15. <i>The Classical Orders of Architecture' Robert Chitham - Architectural Press, 2005</i> 16. <i>'Human Dimensions and Interior Space, a Source Book of Design Reference Standards', Julius Panero, Martin Zelnik – Watson-Guption, 2014</i> 17. <i>Elements of Architecture, Pierre von Meiss, Routledge, 1991</i> |
| Literatura shtesë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>'Architectural Graphic Standards' - J.Wiley & Sons 2001.</i> 2. <i>'Neufert'- Architect's Data, Wiley- Blackwell, 2012</i> |

| | |
|-------------------------------------|--|
| | <ol style="list-style-type: none"> 3. 'Metric Handbook Planning and design data' Adler - Architectural press 2001. 4. 101 things I learned in Architecture School, Mathew Frederick, the MIT Press, 2007 5. 'Formal Design in Renaissance Architecture – from Brunelleschi to Palladio', Michele Furnari – Rizzoli 1995 6. 'Le Corbusier', William J. Curtis – Phaidon 7. 'Architecture for beginners', Louis Hellman – Writers and Readers, 1984 8. 'Design e comunicazione visiva' Bruno Munari - Economica Laterza, 2002 9. 'Grammatica del vedere" – saggi su percezione e gestalt - Biblioteca Il mulino, 1980. 10. 'Luce Colore Visione' – Perché si vede ciò che si vede, Andrea Frova - Biblioteca Universale Rizzoli, 2000 11. 'Le armonie del colore' Augusto Garau - editore Ulrico Hoepli Milano, 1999 12. Poetics of Architecture' Theory of design, Anthony C. Antoniadis - John Wiley&Sons 1992 13. Ngjyra – autor Milot Gusia |
| Plani i dizajnuar i mësimit: | |
| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
| Java e parë: | <p>HYRJE NË LËNDËN BAZAT E PROJEKTIMIT 1</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegimi i sillabusit të lëndës Bazat e Projektimit 1 |
| Java e dytë: | <p>PERCEPTIMI PAMOR</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizimi; Perceptimi me shqisën e të parit; Stimulimi, Organizimi, Seleksionimi, Interpretimi dhe Reaksioni. • Parimet që ndikojnë në procesin e seleksionimit pamor: Intensiteti, Kontrasti, Lëvizja, Madhësia, Përsëritja (Ritmi). Perceptimi i distancave: Dispariteti Binokular; Përputhja; Perspektiva. <p>(ushtrimi/et grafik/e në ndërlidhje me temën e diskutuar)*</p> |
| Java e tretë: | <p>PERCEPTIMI PAMOR</p> <ul style="list-style-type: none"> • Perceptimi i formave: Llojet e kontrastit në fushën pamore: Objekti-prapavija, Objekti-terreni, drita dhe hija në sipërfaqen e objektit, kontrasti në ngjyrë dhe teksturë, theksimi i vijave si prerje të sipërfaqeve – vijat që përcjellin dhe kufizojnë trajtën, rregullat e perspektives lineare, kamuflimi, eliminimi dhe shkatërrimi i formës. • Procesi i organizimit të formave në rrafsh dhe hapësirë (parimet Gestalt): parimi i afërsisë, i ngjashmërisë, i vazhdimësisë, etj) • Iluzioni optik dhe rëndësia e tij në arkitekturë. • Efekti i iradacionit. <p>(ushtrimi/et grafik/e në ndërlidhje me temën e diskutuar)*</p> |
| Java e katërt: | <p>NGJYRAT</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hyrje (ngjyrat në natyrë, zbatimi i ngjyrave në arkitekturë) • Fizika e ngjyrave: veçoritë fizike të dritës, spektri i dritës, ngjyrat subtraktive dhe ato aditive, ngjyrat komplementare spektrale dhe ngjyrat komplementare pigmentare. • Ndjimet themelore të ngjyrave (ndijimet akromatike dhe ato kromatike). <p>(ushtrimi/et grafik/e në ndërlidhje me temën e diskutuar)*</p> |
| Java e pestë: | NGJYRAT |

| | |
|------------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> Sistemet e identifikimit dhe të shënimit të ngjyrave. Sistemi i Ostwaldit, sistemi i J. Ittenit, Sistemi i Munsellit. Trupi i ngjyrave, seksioni i ngjyrave dhe rrethi i ngjyrave. Kontrollimi tipareve përmasave themelore të ngjyrave: kontrollimi i ndritshmërisë/shkëlqimit, intensitetit/pastërtisë dhe cilësisë/ngjyrës). <p>(ushtrimi/et grafik/e në ndërlidhje me temën e diskutuar)*</p> |
| Java e gjashtë: | <p>NGJYRAT</p> <ul style="list-style-type: none"> Dinamika e ngjyrave: Veprimi i ndërsjellë i ngjyrave - Kontrasti simultan. Ndikimi i kontrastit simultan në ndritshmëri, intensitet dhe cilësi të ngjyrës. Ndikimi i ngjyrës në formë; efekti i tonaliteteve të ndryshme; efekti dinamik i ngjyrave dhe zbatimi i tij në arkitekturë. Varshmëria e efektit hapësinor të ngjyrës nga prapavija (prapavija e errët dhe prapavija e çelët). Varshmëria e efektit hapësinor të ngjyrave nga madhësia e sipërfaqeve kontaktuese. Efekti i përputhjes. Ekspresioni i ngjyrave: Cilësia e ngjyrave primare. Harmonia e ngjyrave /akromatike, monokromatike, polikromatike; Harmonia e ngjyrave sipas Ostwaldit, J.Ittenit dhe J. W. Goethe Aplikimi i ngjyrës në arkitekturë - në ndërtesa, në hapësirë publike dhe në enterier <p>(ushtrimi/et grafik/e në ndërlidhje me temën e diskutuar)*</p> |
| Java e shtatë: | <p>RITMI</p> <ul style="list-style-type: none"> Definicioni i ritmit; rëndësia e ritmit në jetën e njeriut; ritmi në arkitekturë; Mundësia e prodhimit të emocioneve adekuate me anë të ritmit në arkitekturë. Mënyrat e formimit të ritmit në arkitekturë me anë të elementeve konstruktive, funksionale dhe dekorative. Llojet e ritmit në arkitekturë: Ritmi i njëtrajtshëm, alternative, i dimensioneve, ritmi progresiv rritës, ritmi progresiv zbritës, ritmi i shpejtuar, ritmi i ngadalësuar, ritmi i hapur dhe ritmi i mbyllur. <p>MASA NË ARKITEKTURË</p> <ul style="list-style-type: none"> Përkufizimi i masës dhe rëndësia e saj në arkitekturë. Elementet me të cilat përcaktohet masa e objektit. <p>Interpretimi i masës (zbatimi i çelësit).</p> <ul style="list-style-type: none"> Elementet që lidhen drejtpërdrejt me përmasat e njeriut; elementet konstruktive dhe materiali ndërtimor; njësitë hapësinore dhe kontrasti; ndarjet në sipërfaqe; tekstura dhe dekorimi; mjedisi që e rrethon objektin. Llojet e masës: masa natyrore, masa intime, masa monumentale, masa traumë. Mënyrat e shprehjes së masës në objektet bashkëkohore arkitekturale. <p>(ushtrimi/et grafik/e në ndërlidhje me temën e diskutuar)*</p> |
| Java e tetë: | <p>Vlerësimi intermediar i njohurisë së nxënë përmasat e njeriut në formë të testit - pyetje-përgjigje.</p> <p>Testi i kollokuimit kryhet në klasa të Fakultetit të Arkitekturës!</p> |
| Java e nëntë: | <p>PROPORCIONET NË ARKITEKTURË</p> <ul style="list-style-type: none"> Përkufizimi; Shqyrtimi i proporcioneve nga aspekti i funksionit, konstruksionit, materialit, masës dhe kohës. Proporcionimi i elementeve të objektit arkitektural. Proporcionimi i katërkëndëshit kënddrejtë. |

| | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> Prerja e artë. Modulatori sipas Le Corbusier dhe teoritë e tjera të proporcionimit. <p><i>(ushtrimi/et grafik/e në ndërlidhje me temën e diskutuar)*</i></p> |
| Java e dhjetë: | <p>SEKUENCAT NË ARKITEKTURË</p> <ul style="list-style-type: none"> Sekuencat në arkitekturë. Përjetimi i objektit arkitektural në sekuencat e njëpasnjëshme duke iu afruar objektit. Rëndësia e theksimit adekuat të hyrjes; sekuencat pas hyrjes në objekt. Dozimi i interesit dhe klimaksi. Krijimi i përgatitjeve në vazhdimësi, në drejtim të klimaksit. Llojet e sekuencave (formale dhe joformale) <p>LËVIZJA NË ARKITEKTURË</p> <ul style="list-style-type: none"> Përjetimi i objektit arkitektural gjatë lëvizjes dhe format dhe kategorizimi i shtigjeve të lëvizjes nëpër objekt dhe përreth tij. <p><i>(ushtrimi/et grafik/e në ndërlidhje me temën e diskutuar)*</i></p> |
| Java e njëmbëdhjetë: | <p>KARAKTERI NË ARKITEKTURË</p> <ul style="list-style-type: none"> Përkufizimi i karakterit të objektit arkitektural; Mënyrat e shprehjes adekuate e funksionit dhe e domethënies së objektit; Mënyrat e shprehjes së porosisë ideore të arkitektit – krijues. Si arrihet shprehja adekuate e karakterit të objektit? Përdorimi i formave konvencionale. Përdorimi i formave–simboleve. Thjeshtësia dhe ndërlíkueshmëria e gabaritit. Përdorimi i ngjyrës. Linja dhe ritmi. <p><i>(ushtrimi/et grafik/e në ndërlidhje me temën e diskutuar)*</i></p> |
| Java e dymbëdhjetë: | <p>TEKSTURA DHE DRITA NË ARKITEKTURË</p> <ul style="list-style-type: none"> Tipet e teksturave Materiali dhe tekstura Drita në arkitekturë <p><i>(ushtrimi grafik në ndërlidhje me temën e diskutuar)*</i></p> |
| Java e trembëdhjetë: | <p>Vlerësimi i dytë semestral i njohurisë së nxënë përmes Kolokuiumit të dytë në formë të testit pyetje-përgjigje.</p> |
| Java e katërbëdhjetë: | <p>REKAPITULIMI I Pjesës së parë të kapitujve të ligjeruar gjatë semestrit <i>(ushtrimi/et grafik në ndërlidhje me temën e diskutuar)</i></p> |
| Java e pesëmbëdhjetë: | <p>REKAPITULIMI I Pjesës së dytë të kapitujve të ligjeruar gjatë semestrit</p> |
| Vërejtje: | |
| <p>* Mediumet dhe formatet e detyrave i përcakton mësimdhënësja varësisht nga tematika. Mësimdhënësja rezervon të drejtat të shtojë, të largojë apo të modifikojë numrin, llojin dhe mediumin, si dhe teknikat e realizimit të ushtrimeve/ detyrave grafike varësisht nga vlerësimi i dinamikës së të nxënëit të njërive mësimore nga ana e studentëve gjatë semestrit.</p> <p>Mësimdhënësja rezervon të drejtën për ta bërë ndërrimin eventual të renditjes së temave (që ligjërohen, si dhe të detyrave grafike) apo/ dhe të ligjërimit “bllok” të temave të caktuara, nëse vlerësohet se një renditje tjetër apo ligjërimit “bllok” i grupeve tematike kontribuon në nxënie më të mirë të temave të caktuara nga studentët.</p> | |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Rregullat e mirësjelljes:

- Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obligueshëm.
Me më shumë se **3 mungesa të arsyeshme ose të paarsyeshme** (ligjëratë+ushtrime), studentit nuk i lejohet vazhdimi i lëndës në vitin përkatës akademik dhe detyrohet që ta përsëris lëndën në vitin e ardhshëm akademik.
- Mbajtja e qetësisë në mësim
- Ndalja e telefonave celularë
- Hyrja në mësim me kohë

Të drejtë për t'iu nënshtruar provimit nga lënda BAZAT E PROJEKTIMIT 1 kanë:

- studentët të cilët i kanë dorëzuar me kohë të gjitha detyrat grafike në afatet e përcaktuara nga mësimdhënësja;
- studentët të cilëve të gjitha punimet grafike të punuara gjatë semestrit iu vlerësohen me notë pozitive (6-10),
- studentët të cilët nuk kanë më shumë se tre mungesa të arsyeshme/ të paarsyeshme në ligjërata ose ushtrime.

Në të kundërtën studentët do të përsërisin lëndën në vitin e ardhshëm akademik!

Prishtinë, 03.10. 2023